

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.28.12.2020*

28.12.2020

Ora 17:30

RENDI I DITËS

Projektvendim "Për caktimin e rregullave për administrimin dhe shpërndarjen e vulës rezervë të Komisionit të Qendrës së Votimit"

PJESËMARRJA :

- **KQZ:**
- **Ilijan CELIBASHI Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**
- **Komisioni Rregullator:**
- **Ilijana NANO Kryetar**
- **Arens ÇELA Anëtar**
- **Dritan ÇAKA Anëtar**
- **Helga VUKAJ Anëtar**
- **Muharrem ÇAKAJ Anëtar**
- **Stafi KQZ: Y.Merkaj, N.Mezini**
- **Parti Politike: PD, LSI, PSD**
- **Vëzhgues:**

Znj.I.Nano: Mirëmbërëma! Shoh që janë në linjë të gjithë anëtarët e Komisionit Rregullator, Komisioneri, mund të nisim mbledhjen e Komisionit Rregullator. Në mbledhjen e sotme kemi për të shqyrtuar dhe miratuar një projektvendim "Për caktimin e rregullave të administrimit dhe shpërndarjes së vulës rezervë të komisionit të qendrës së votimit". Janë të pranishëm në mbledhje të pestë anëtarët e Komisionit Rregullator, është i pranishëm Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

*Zbardhi materialin e inçizuar
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.28.12.2020*

zoti Ilirjan Celibashi, gjithashtu të pranishëm janë përfaqësues të partive politike, po shoh zotin Kaziaj, kemi edhe nëpunës të administratës së KQZ, Sekretarin e Përgjithshëm dhe zyrtarë të tjerë të KQZ. Ky akt është në vazhden e akteve që kemi miratuar në përgatitje të procesit zgjedhor. Rregullat për administrimin dhe shpërndarjen e vulës rezervë janë të diktuar për t'u miratuar nga Komisioni Rregullator nisur nga parashikimet e nenit 103 të Kodit Zgjedhor sigurisht duke përjashtuar ato raste që përbëjnë vepër penale sipas nenit 326/a të Kodit Penal. Do të ftoja për të prezantuar aktin dhe për të përmbledhur relacionin Komisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve zotin Ilirjan Celibashi.

Z.I.Celibashi: Faleminderit zonja Nano, ky akt është një akt i cili është në kompetencën e Komisionit Rregullator për tu shqyrtuar dhe për tu miratuar. Vjen në përmbushje të detyrimeve që ka Kodi Zgjedhor bazuar në nenin 103 të këtij Kodi paragrafi një i cili parashikon që në pjesën e pasme të fletës së votimit të vulozet fleta e votimit me vulën e KQV-së dhe Kryetarit të KQV-së. Në rast se vula e KQV-së ose vula e Kryetarit të KQV-së është dëmtuar ose është nxjerrë jashtë qendrës së votimit KQV-ja pajiset menjëherë me vulën rezerve. Duke marrë në konsideratë këtë përcaktim të Kodit Zgjedhor dhe detyrimin që gjithashtu përcakton Kodi Zgjedhor për nxjerrjen e aktit normativ pikërisht për të përcaktuar procedurat për zëvendësimin e vulës së nxjerrë jashtë përdorimit ne i kemi propozuar Komisionit Rregullator aktin që gjendet bashkëngjitur këtij relacioni. Në mënyrë të përmthledhur sjell në vëmendje që ky projektvendim kërkon në mënyrë të posaçme aspektet që kanë të bëjnë me sasinë e vulave rezervë. Rregullat që kanë të bëjnë me nxjerrjen jashtë përdorimit të vulës së KQV-së apo vulës së kryetarit të KQV-së. Rregullat mbi administrimin dhe shpërndarjen e vulave rezervë përmes nëpunësve të administratës të autorizuar në mënyrë të posaçme nga Komisioneri

*Zbardhi materialin e inçizuar
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.28.12.2020*

Shtetëror. Procedurën, e cila konsiston në mbajtjen e një procesverbali ku përshkruhen rrethanat dhe ora e dëmtimit apo nxjerrjes jashtë qendrës së votimit të vulës që zhvillohet në rastin e dëmtimit apo nxjerrjes jashtë qendrës së votimit vula e Kryetarit apo e vetë KQV-së. Procedura e dorëzimit së vulës rezervë në KQV, kjo procedurë kryhet vetëm nga nënpunës së administratës së KQZ të autorizuar në mënyrë të posaçme nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, dokumentohet në një procesverbal të veçantë. Gjithashtu përcaktohen dhe rastet e nxjerrjes jashtë qendrës së votimit të vulës së KQV-së apo vulës së Kryetarit të KQV-së dhe aspekti rregullator sipas të cilës KQZ referon kur është rasti materialin kallëzues pranë orgatit të prokurorisë së rrethit gjyqësor përkatës në rastet kur verifikohen shkelje të karakterit penal. Pak a shumë kjo është përmbledhja dhe këto janë ato aspektet e aktit, faleminderit.

Znj.I.Nano: Faleminderit zoti Celibashi! Sigurisht ashtu sikur e cilësuat edhe ju ky është një akt i rëndësishëm për t'i paraprirë situatave që mund të ndodhin ditën e zgjedhjeve në qendrën e votimit ku mund të dëmtohet dhe bëhet fjalë për dëmtim padashje të vulës së qendrës së votimit. Unë do të çelja diskutimin në parim për aktin dhe më së pari ftoj kolegët anëtarë të Komisionit Rregullator të diskutojnë në parim, më tej përfaqësuesit e partive politike, konkretisht zotin Kaziaj që është në linjë. Po zonja Vukaj!

Znj.H.Vukaj: Faleminderit zonja Nano. Do të doja të thosha dy fjalë për aktin sepse edhe ky akt gëzon rëndësinë e tij pavarësisht se në dukje duket si një akt formalo-procedural por për sa kohë ky akt do të përçojë në njëfarë mënyre garanci të një prej instrumentave në rast se do të ndodhë gjithmonë të procesit zgjedhor mendoj që meriton edhe dy fjalë më tepër. Ky akt siç e dimë nga përvoja apo

*Zbardhi materialin e inçizuar
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.28.12.2020*

leximi i kuadrit ligjor dhe njohja me praktikën në retrospektivë vjen si praktikë e njohur, çliruese nga zgjedhjet e mëparshme të cilat në njëfarë mënyre kanë krijuar vërtet një traditë dhe kanë qenë zgjidhja për ato raste. Unë do të doja të përshendesja Komisionerin i cili ka marrë në konsideratë përvojën e mëparshme, opinionet aktuale edhe sensin pozitiv që ka pasur për të reflektuar ato pjesë të cilat mund të konsiderohen si risk apo nga palët do të shtonin garancinë, flas për palët e papërfaqësuar, garancinë më shumë në këtë proces zgjedhor. Pasi palët siç e dimë nuk kanë më të njejtat garanci siç kanë qenë në retrospektivë atëherë kur edhe lindi ky debat apo u krijua. Por për hir të precedentëve që ato kanë ekspozuar nëpërmjet procedimeve penale apo kanë ekspozuar mediatikisht, kanë dashur apo kanë pasqyruar dhe sjellë rastet se kur mund të cëdohet mbi këtë proces. Prandaj që edhe unë përgëzoj që në mbajtje të këtij akti gjenden këto pika të cilat kanë të bëjnë si me punonjës të autorizuar dhe garancinë që do të japë ky punonjës i autorizuar i cili jo vetëm në këndvështrimin tim por edhe në këndvështrimin e Komisionerit i cili ka absolutisht përgjegjësinë, por njëkohësisht do ta ndjekë me shumë prioritet edhe këtë proces sikundër edhe proceset e tjera. Duhet dhënë garancia aty që ky do të jetë një punonjës i përhershëm dhe jo i përkohshëm dhe në të njejtën kohë stacionimi i tij do të sugjeroja në zbatim që të ishte në KQZ pasi arritja në çdo pikë ku mund të ndodhë një event i tillë tashmë me aksesin infrastrukturor mund të realizohet shumë shpejt por siç ka treguar përvoja kjo mund të arrihet edhe me mjete të tjera komunikimi të cilat mund të jenë në dispozicion të Ministrisë së Mbrojtjes, apo Ministrisë së Brëndshme. Këto janë ato pikat që doja të sillja në vëmendje për publikun i cili meriton ta dijë dhe ta ketë të qartë që këto akte nuk pasqyrohen thjesht me anë të një takimi zoom por këto marrin vëmendjen e duhur, shqyrtohen nga të gjitha palët midis kolegësh, jepen mendime dhe në të njejtën

*Zbardhi materialin e inçizuar
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.28.12.2020*

kohë opinione dhe shtesa të cilat për ekonomikitet të kohës së publikut dhe të medias ezaurohen paraprakisht. Faleminderit zonja Nano, kaq kisha.

Znj.I.Nano: Faleminderit zonja Vukaj, unë kisha një pyetje drejtuar Komisionerit meqënëse është akt i përgatitur nga administrata e KQZ-së. Në nenin 3 pika a parashikohet: Ndërtesat ku qëndrojnë nëpunësit e administratës së KQZ-së të autorizuar në mënyrë të posaçme nga Komisioneri për shpërndarjen e vulës rezervë plotësojnë kriteret e parashikuara në nenin 93. Ku neni 93 i referohet qendrave të votimit, selive të KZAZ-ve dhe vendeve të numërimit të votave. Ndërkohë në pikën 7 të këtij projektvendimi aty ku flitet për administrimin dhe dorëzimin e vulës rezervë në pikën b thuhet: Dorësimi i vulës rezervë kryhet në mjediset e qendrës së votimit përkatëse. Pyetja ime është çfarë nënkuptojnë këto ndërtesa ku qëndrojnë punonjësit e autorizuar te KQZ-së? Sepse është një pikë e shtuar pas konsultimeve dhe me partitë politike pra për cilat ndërtesa bëhet fjalë? Dorëzimi i vulave bëhet në qendrën e votimit, punonjësi autorizohet nga Komisioneri për të bërë zëvendësimin e vulës, por personalisht nuk e kuptoj për cilat ndërtesa bëhet fjalë.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Jona DERVISHI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.28.12.2020*

Z.I.Celibashi: Në fakt nuk flitet për një ndërtesë specifike, por si e tillë mund të jetë KZAZ-ja një ndërtesë e tillë ku mbahet e administrohet në mënyrë të posaçme vula në rezervë. Nuk është se nënkupton një ndërtesë specifike, sepse nuk do të kishte sens që të ishte një ndërtesë specifike thjesht dhe për të mbajtur vulën rezervë.

Znj.I.Nano: Kolegët e tjerë nëse kanë ndonjë pyetje apo ndonjë diskutim në parim lidhur me projektvendimin?

Z.D.Caka: Në parim jo, po shpresoj në momentin që do të kalohet pikë për pikë projektvendimi dhe unë kisha diçka që nuk do ta shtoja por besoj më pas.

Znj.I.Nano: Zoti Çela, zoti Çakaj keni diçka për projektvendimin në parim?
Atëherë zoti Kaziaj si përfaqësues i një subjekti që sot është i pranishëm i Lëvizjes Socialsite për Integrim. Nëse keni diçka?

Z.A.Kaziaj, përfaqësuesi i LSI: Përshëndetje të gjithëve. Jo, veç faktit që jam dakord me sa u tha aty nga zonja Vukaj për sa i përket pjesës së karakterit ndonëse formal por shumë të rëndësishëm të këtij akti se përbën një nga pikat, po themi kryesore, që janë të procesit zgjedhor në tërësi. Do të doja thjesht të bëja me dije rregullatorin, për shkak duke e lidhur dhe me atë që thashë në precedencë para dy seancash publike. Për sa i përket pjesës së dërgimit të akteve do të donim që akti të ishte final para se të dërgohej.....Po bëjmë të themi një punë të dyfishtë duke u bazuar në një akt dhe pastaj fill pas mbledhjes na dërgohet një akt tjetër.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Valbona Dushi*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.28.12.2020*

Kështu që do të kishim një kërkesë të posaçme që të merret parasysh nga ana e kabinetit të Komisionerit, që drafti përfundimtar do t'i dërgohet partive politike në momentin që është përfundimtar, jo që dërgohet një paraprak dhe pastaj dërgohet përfundimtari.

Znj.I.Nano: Zoti Kazia, shqetësimin tuaj në çdo rast ne do t'ja përcjellim Komisionerit, ai është prezent dhe u njoh me këtë shqetësim.

Z.I.Celibashi: Mund të bëj vetëm një sqarim lidhur me këtë çështje. Kjo qëndron kështu sikurse e tha zoti Kazia, por vjen për shkak të një rrethane objektive. Ne përgatisim aktet, ua dërgojmë partive për konsultim, organizatave të Shoqërisë Civile duke lënë në dispozicion një periudhë realitivisht të shkurtër të themi për konsultim prej dy ditësh dhe në momentin që ,qoftë dhe në fund të periudhës dy ditore dikush sjell disa komente për t'u konsideruar, ne i konsiderojmë dhe koha është e tillë që na bën të gjithëve që në variantin final pastaj kur reflektojmë ato rekomandimet e sjella, t'i përfshijmë thuajse në momentin e fundit. Nëse do të duhet dhe kërkojmë kohë më shumë pastaj është në çmimin tuaj si rregullator që t'i jepni pak kohë më shumë partive politike.

Z.A.Kaziaj, përfaqësuesi i LSI: Zoti Celibashi unë personalisht e kam marrë aktin sot me postë elektronike në orën 1, aktin e parë. Nuk e vë në dyshim që ka pasur sugjerime dhe nga ana e rregullatorit në këtë rast. Do të ishte mirë që ne ta kishim në një afat të arsyeshëm dhe të themi draftin final përfundimtar si mund ta quajmë mbi të cilin do të diskutohet dhe mbi të cilin ne mund të pasqyrojmë të themi ato që janë interesa tona si parti politike.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Valbona Dushi*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.28.12.2020*

Z.I.Celibashi: Qëndron si shqetësim do të përpiqemi që të reflektojmë të gjitha rekomandimet brenda një afati të arsyeshëm që të vihet në dispozicion koha e përshtatshme për ju për të parë versionin përfundimtar.

Z.A.Kaziaj, përfaqësuesi i LSI: Ju faleminderit!

Znj.I.Nano: Zoti Kazia vetëm për të saktësuar diçka në draftin që po diskutojmë tani në mbledhje publike janë reflektuar mendime të partive politike jo të anëtarëve të rregullatorit. Ata janë tani duke diskutuar mbi aktin. Atëherë, nëse nuk kemi diskutime të tjera në parim lidhur me aktin, do të ftoja anëtarët e Komisionit Rregullator të votojmë në parim projektvendimin “Për caktimin e Rregullave të Administrimit dhe Shpërndarjes së vulës rezervë të Komisionit të Qendrës së Votimit”

Kush është pro me projektvendimin?

Pro:5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Miratohet në parim, kalojmë në diskutimin nen për nen ose pikë për pikë.

E nisim me pikën 1, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve prodhon një vulë rezervë për çdo qendër votimi me tekst unik, i cili përmban numrin e qendrës së votimit dhe fjalën “rezervë”. Sipas rregullores sonë më së pari fjalën e kanë përfaqësuesit e partive politike. Zoti Kazia?

Z.A.Kazia, përfaqësuesi i LSI: Jam dakord.

Znj.I.Nano: Anëtarët e Komisionit?

*Zbardhi materialin e inçizuar
Valbona Dushi*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.28.12.2020*

Anëtarët e Komisionit: Dakord!

Znj.I.Nano: Nuk kemi ndonjë sugjerim për shtesa apo ndryshim. Votojmë pikën 1 ju lutem.

Kush është dakord?

Pro:5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Miratohet pika 1 e projektvendimit.

Pika 2, nxjerrja jashtë përdorimit të vulës së komisionit të qendrës së votimit apo të vulës së kryetarit të qendrës së votimit dhe zëvendësimi i saj me vulë rezervë bëhet me vendim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Nëse ka propozime për shtesa apo ndryshime? Nuk ka.

E votojmë pikën 2 ju lutem?

Kush është dakord?

Pro:5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Miratohet pika 2 sipas projektit të paraqitur.

Vijojmë me pikën 3 të projektvendimit. Vulat rezervë të qendrave të votimit administrohen dhe shpërndahen nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve përmes nëpunësve të administratës së KQZ-së të autorizuar në mënyrë të posaçme nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve. Germa "a", ndërtesat ku qëndrojnë nëpunësit e administratës së KQZ-së të autorizuar në mënyrë të posaçme nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve për administrimin dhe shpërndarjen e vulës rezervë të komisionit të qendrës së votimit, plotësojnë kriteret e parashikuara në nenin 93 të ligjit 10 019 datë 29.12.2008, Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë të ndryshuar. Germa "b", lista e nëpunësve të autorizuar në mënyrë të posaçme nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve për të administruar dhe shpërndarë vulën rezervë të komisionit të qendrës së votimit dhe adresat e ndërtesave ku ata



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.28.12.2020*

qëndrojnë, menjëherë publikohen në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe u njoftohen partive politike. Kemi ndonjë propozim për shtesë, ndryshim ndonjë koment lidhur me këtë nen ju lutem?

Unë kam vetëm një pyetje në fakt që ndoshta duhet ta kisha bërë, Jam te germa “b”, ku flitet për listën e nëpunësve dhe adresat e ndërtesave menjëherë publikohen në faqen zyrtare, çdo të thotë “menjëherë”?

Z.A.Kaziaj, përfaqësuesi i LSI: Menjëherë nga momenti i autorizimit, nga momenti që merret vendimi ose përgatiten këto lista, ose autorizohen personat.

Znj.I.Nano: Atëherë nëse nuk ka ndonjë propozim për shtesa apo ndryshim, ftoj kolegët të votojmë për pikën 3.

Kush është dakord?

Pro:5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kalojmë në pikën 4 të projektvendimit. “Në rastet e dëmtimit apo nxjerrjes jashtë qendrës së votimit të vulës së Komisionit të qendrës së votimit apo të vulës së Kryetarit të qendrës së votimit “a” sekretari i Komisionit të qendrës së votimit mban procesverbal në librin e protokollit të mbledhjeve të Komisionit të Qendrës së Votimit, ku shënon rrethanat dhe orën e dëmtimit apo nxjerrjes jashtë qendrës së votimit të vulës përkatëse. Procesverbali firmoset nga anëtarët e komisionit të qendrës së votimit. “B” Kryetari sekretari apo çdo anëtar i Komisionit të qendrës së votimit njofton menjëherë sekretarin e komisionit të zonës administratimit zgjedhor përkatës për rrethanat, orën e dëmtimit apo nxjerrjes jashtë të qendrës së votimit të vulës, llojin e vulës dhe kërkon zëvendësimin e saj me vulën rezervë. Njoftimi dhe kërkesa bëhet ndërmjet telefonit celular me mesazh zanor ose tekst të



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.28.12.2020*

shkruar. Zoti Kazia, zoti Nuraj përfaqësues të partive politike më së pari nëse keni ndonjë pyetje?

Z.A.Kaziaj, përfaqësuesi i LSI: Kisha një pyetje nëse mundem zonja Nano.

Në shkronjën “a”, thuhet sekretari i Komisionit të Qendrës së Votimit mban procesverbalin në librin e protokollit të mbledhjeve të komisionit të qendrës së votimit ku shënohen rrethanat dhe orën e dëmtimit apo nxjerrjes jashtë qendrës së votimit të vulës përkatëse. Po në qoftëse është sekretari ai që nxjerr jashtë qendrës së votimit vulën? Kush e mban procesverbalin?

Z.I.Celibashi: Në çfarë kuptimi?

Z.A.Kaziaj, përfaqësuesi i LSI: Në kuptim që në një rrethanë, në një moment lajthitjeje ose në një akt të kësaj natyre, sekretari merr vulën dhe del jashtë.

Znj.A.Tenolli: Në këtë rast duhet të ketë një person zëvendësues ose person të autorizuar. Edhe komisioni i qendrës së votimit është i ngritur në nivel paritetit mbi partizan dhe si në të gjitha procedurat e tjera kur sekretari i komisionit të qendrës së votimit është i larguar një anëtar tjetër që i përket të njëjtës parti politike, kryen funksionet e tij dhe në këtë rast mban edhe librin e protokollit të mbledhjeve të komisionit të qendrës së votimit ku shënon faktin e largimit të sekretarit dhe faktin që ai po ushtron detyrat e sekretarit. Është një procedurë që zbatohet edhe për raste të tjera kjo e kalimit të detyrës tek një anëtar tjetër i së njëjtës përkatësi politike.

Z.A.Kazia, përfaqësuesi i LSI: Do të duhet të ishte pasqyruar kjo në akt?



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.28.12.2020*

Znj.A.Tenolli: Është e përcaktuar në Kodin Zgjedhor dhe ... pjesë e manualit të Komisionit të Qendrës së Votimit që për këtë rast dhe çdo rast tjetër kur ka largim të sekretarit qoftë dhe të kryetarit. Anëtarët respektiv të kaheve respektive politike vazhdojnë ushtrojnë detyrat në emër të tyre.

Z.D.Caka: Është e vërtetë se kjo është e njëjtja procedurë që zbatohet, ashtu siç dhe zonja Tenolli tha edhe në rastet edhe kur kryetari mund të largohet sepse këto nuk janë vetëm raste që largimi mund të bëhet për efektet e nxjerrjes së vulës ose për largim përfundimtar. Mund të jenë dhe largime momentale sepse nga Komisioni i Qendrës së Votimit si kryetari ose sekretari ose dhe anëtarët mund të largohen edhe për nevoja të caktuara. Kështu që është e përcaktuar dhe në Kodin edhe në materiale, siç tha është praktike dhe e njohur në të gjitha zgjedhjet që zëvendësohen që shënohet në librin e protokollit, madje në qoftë se përshembull dhe kryetari largohet, përcaktohet dhe shënohet dhe në librin e protokollit në mbledhje edhe kush anëtar zëvendësues do të luaj rolin e nënkryetarit, merr dhe vulën e kryetarit. Besoj se në momentin që këto janë standarte të përcaktuara për largimet so të kryetarit, sekretarit edhe çdo anëtar, besoj se është e tepërt që përcaktohen këtu sepse kjo është procedurë standarte. Mendimi im personal është që nuk ka arsye zoti Kazia për t'u shtuar këtu për të bërë një dublim kur kjo është e përcaktuar megjithatë...

Znj.I.Nano: Pra idea është që kur themi sekretari nënkuptojmë si sekretarin në detyrë si sekretarin zëvendësues, në çdo rast kur ushtron detyrën e sekretarit kryen dhe këtë detyrë.



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.28.12.2020*

Znj.H.Vukaj: Megjithatë në qoftë se zoti Kazia e sheh të paplotësuar në këndvështrimin e një të tretë ose të një zbatuesit të këtij akti, ndoshta një referencë mund t'i vihet pikës ose nëse ka zoti Kazia ndonjë propozim?

Z.A.Kaziaj, përfaqësuesi i LSI: Më shumë e shoh si një gjë zonja Vukaj, që sjell pasoja edhe të pezullimit të procesit vetëm keqadministrimit të procesit dhe pasoja të karakterit penal dhe në këtë rast duke qenë se jemi përpara një fakti që është shumë i rrallë ose s'mund të ndodhë, por edhe mund të ndodhë nuk na jep garanci askush që një gjë e tillë nuk mund të ndodhë nga sekretari i Komisionit të Qendrës së Votimit. Kështu që do të doja që të reflektonte Rregullatori, në qoftë se e sheh të mundshme për të ngarkuar me përgjithësi, për të dhënë dhe të themi ato që janë specifikat përkatëse në këtë akt pse jo...



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.28.12.2020*

Znj.I.Nano: Edhe njëherë nëse keni propozim. Po zonja Tenolli ju lutem!

Znj.A. Tenolli: Për sa po diskutoni është parashikimi i nenit 102 paragrafi 2, që bën fjalë për rastet kur kryetari largohet, kalon materialet zgjedhore që ka tagër ai ti administrojë tek një anëtar tjetër i komisionit me të njëjtën përkatësi politike sikundër parashikohet edhe rasti kur sekretari i Komisionit të Qendrës së Votimit largohet kalon edhe vulën meqe po flasim për përgjegjësi edhe vulën edhe librin e protokollit të Qendrës së Votimit, tek një anëtarë tjetër i komisionit me të njëjtën përkatësi politike.

Znj.I.Nano: Deri në rikthimin e sekretarit është kjo situatë. Pra, kodi e ka parashikuar edhe këtë situatë. Atëhere, të nderuar kolegë, zoti Kaziaj besoj se jeni tashmë të qartë edhe aq më tepër në mungesë të një propozimi konkret nga ana juaj do të më duhet të kaloj për votim pikën 4.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj,z.Çakaj)

Kundër: S'ka!

Miratohet!

Të nderuar kolegë, jemi përsëri të limituar. Kështu që unë do të nisja me leximin e pikës 5, Sekretari i Përgjithshëm dhe zonja Tenolli janë të pranishëm në mbledhje kështu që nëse do të kemi ndonjë pyetje mund t'ia drejtojmë, pyetje teknike t'ia u drejtojmë atyre. Atrëhere pika 5 e projekt vendimit: “ Sekretari i Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor:

- a) Shënon në librin e protokollit të mbledhjeve të Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor numrin e Qendrës së Votimit orën dhe rrethanat e njoftuara nga Komisioni Qëndrës së Votimit përkatës. Llojin e vulës e cila

*Zbardhi materialin e inçizuar
Ardita VRIONI*

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.28.12.2020*

kërkohet të zëvendësohet, emrin dhe pozicionin e anëtarit të Komisionit të Qendrës së votimit që bëri njoftimin.

- b) Njofton menjëherë Komisionin e Zonës së Administrimit Zgjedhor dhe Komisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve përmes administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe i paraqet kërkesën për nxjerrjen nga përdorimi të vulës të Komisionit të Qendrës së Votimit ose vulës së Kryetarit të Komisionit të Qendrës së Votimit përkatës dhe zëvendësimin e saj me vulën rezervë. Kërkesa përmban numrin e Komisionit të Qendrës së Votimit orën dhe rrethanat e njoftuara nga Komisioni i Qendrës së Votimit. Llojin e vulës që kërkohet të zëvendësohet numrin serial në rastin e vulës së kryetarit të komisionit të qendrës së votimit emrin edhe pozicionin e anëtarit të komisionit të Qendrës së Votimit që njoftoi Komisionin e Zonës së Administrimit Zgjedhor. Kërkesa paraqitet me shkrim, firmoset nga Sekretari i Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor dhe sipas rastit nga kryetari dhe/ose zëvendës Kryetari i Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor, vuloset me vulën e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor dhe dërgohet përmes rrugëve elektronike të komunikimit.

Zoti Nuraj, përfaqësues të partive të tjera politike nuk kemi. Ju keni ndonjë propozim konkret? Për shtesë apo ndryshim?

Z.L.Nuraj, përfaqësues i PD-së: përfaqësues i: Jo, e nderuar, jemi njohur paraprakisht, jemi dakordësuar më herët. Kështu që dakord.

Znj.I.Nano: Në rregull, të nderuar kolegë, anëtarë të komisionit! Kemi ndonjë propozim konkret? Mesa shoh nuk kemi! Ju ftojë të votojmë pikën 5 sipas tekstit të propozuar nga komisioneri!

Kush është dakord?

*Zbardhi materialin e inçizuar
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.28.12.2020*

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj,z.Çakaj)

Kundër: S'ka!

Miratohet!

Znj.I.Nano: Pika 6: “ Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve:

a) Pas administrimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të njoftimit, kërkesës të Sekretarit të Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor merr vendim për nxjerrjen jashtë përdorimit të vulës të Komisionit të Qendrës së Votimit apo të kryetarit të Qendrës së Votimit përkatës, dhe zëvendësimit të saj me vulën rezervë. Në vendimin përcaktohet ora e marrjes së vendimit, numri i Qendrës së Votimit, teksti i vulës që nxirret nga përdorimi dhe teksti i vulës rezervë që zëvendëson vulën e nxjerrë nga përdorimi.

b) Në rrugë elektronike të komunikimit nëpërmjet administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dërgon menjëherë kopje të vendimit sipas shkronjës “a” të këtij paragrafi tek:

i) Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor përkatës i cili ka nën juridiksion Qendrën e Votimit ku do të zëvendësohet vula e nxjerrë jashtë përdorimit me vulë rezervë. 2 i) Nënpunësi i administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve i autorizuar në mënyrë posaçme nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve për administrimin dhe shpërndarjen e vulave rezervë në qarkun ku përfshihet Komisioni i Zonës së Administrimit Zgjedhor, Komisioni i Qendrës së Votimit përkatës.

Përfaqësuesit e partive politike nëse kanë diçka mund të kërkojnë fjalën. Nëse jo! Anëtarët e Komisionit Rregullator, propozim për shtesë, ndryshim në këtë pikë. Ose ndonjë pyetje apo ndonjë koment? Po zonja Vukaj!

*Zbardhi materialin e inçizuar
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.28.12.2020*

Znj. H.Vukaj: Ndjesë për kushtet. Besoj që në këtë kuadër edhe me atë që relatoi komisioneri besoj që në përgjegjësitë që ai etiketoi dhe nën përgjegjësinë penale, që përmëndi për të gjithë ata që abuzojnë me të gjithë etapat e procesit, të ketë parasysh edhe këtë kontigjent i cili ka një detyrë shumë të rëndësishme. Kjo ishte një parantezë dhe një sqarim. Sepse në zbatim pastaj është përgjegjësi dhe kompetencë e komisionerit.

Znj.I.Nano: Në rregull! Në mënyrën se si është shkruar zonja Vukaj keni ndonjë propozim? Apo e donit thjesht për ta komentuar?

Znj. H.Vukaj: Është thjesht një koment por doja ta lidhja me atë që përmendi komisioneri. Domethënë që mund ta marrin garancinë që këtu, që e ka nënsuazën e atij argumenti që dha për të gjithë kategoritë e personave qoftë të autorizuar apo të përfshirë në proces të cilët ngarkohen me administrimin e procesit në tërësi jo vetëm të vulave rezervë. Kjo është më tepër për përgjegjësinë që duhet të marrë, ai që do autorizohet për vulën rezervë.

Znj.I.Nano: E qartë! Atëherë të nderuar kolegë, po rikthehemi tek votimi!

Kush është dakord me pikën 6?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj,z.Çakaj)

Kundër: S'ka!

Miratohet!

Znj.I.Nano: Viojmë me pikën 7 të tij! “Administrimi dhe dorëzimin i vulës rezervë në Komisionin e Qendrës së Votimit përkatës ndjek hapat e mëposhtme,” kjo në fakt është procedura sikundër komisioneri e theksoi gjatë prezantimit.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.28.12.2020*

a) “Kryhet me përgjegjësi të plotë nga punonjësi i administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve i autorizuar në mënyrë të posaçme nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

b) Dorëzimi i vulës rezervë kryhet në mjediset e qendrës së votimit përkatëse në prani të anëtarëve të Komisionit të Qendrës së Votimit. Dokumentohet në material filmik dhe procesverbal të veçantë sipas lidhjes 1 bashkëlidhur.

c) Nënpunësi i administratës së Komisionit Zgjedhor të Zgjedhjeve njofton menjëherë Komisionin e Zonës së Administrimit Zgjedhor dhe Komisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve për orën e dorëzimit të vulës rezervë në Komisionin e Qendrës së Votimit përkatës.

ç) Sekretari i Komisionit të Qendrës së Votimit, shënon në librin e protokollit të mbledhjeve të Komisionit të Qendrës së Votimit orën e marrjes në dorëzim të vulës rezervë dhe nënpunësit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që kreu dorëzimin.

d) Vula e dëmtuar merret në dorëzim nga nënpunësi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe asgjësohet në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.

Po i drejtohem edhe njëher për këtë pikë zoti Kaziaj, zoti Nuraj si përfaqësues të partive politike nëse kanë koment apo propozim për shtesë apo ndryshim! Nuk ka! Të nderuar anëtarë të Komisionit Rregullator koment? Po zoti Çaka! Pastaj zonja Vukaj!

Z.D.Çaka: Po, unë kisha në rradhë të parë për element shpjegues, këtë doja tia drejtoja në formën e një pyetje Komisionerit Shtetëror në pikën b thotë: “ Dorëzimi i vulës rezervë kryhet në mjediset e qendrës së votimit përkatëse në prani të anëtarëve të Komisionit të Qendrës së Votimit”. Deri këtu është mëse normale dhe thotë : “Dokumentohet në material filmik”... Pyetja ime është ky dokumentim në material filmik, do të kryhet nga punonjësi i cili bën dorëzimin pra

*Zbardhi materialin e inçizuar
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.28.12.2020*

nëpunësi i administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve , nga anëtarë të komisionit, me çfarë mjeti do të bëhet? Dhe pasi bëhet ky dokumentim që thuhet këtu, ky dokumentim, pra ky material filmik ku administrohet, ku dorëzohet?

Z.I.Celibashi: Po! Ne sikurse mund të keni dijeni kemi parashikuar që në çdo Qendër Votimi të vendoset kamera të cilat vëzhgojnë dhe monitorojnë veprimtarinë që zhvillohet në Qendrën e Votimit kuptohet pa cënuar elementët e fshehtësisë së votimit. Por mund të jetë rasti që ky si moment mund të administrohet edhe në forma të tjera të regjistrimit filmik. Dhe pastaj secila prej palëve mund të disponoj mbi të në mënyrën që ajo e çmon.

Znj.I.Nano: Zoti Çaka keni propozim konkret?

Z.D.Çaka: Të paktën në vlerësimin tim në momentin që thuhet dokumentohet në material filmik dhe pjesë e gjithë dokumentimit që ndodh në një ...

Znj.I.Nano: Qendër Votimi.

Z.D.Çaka: Pra i gjithë procesi zgjedhor brenda Qendrës së Votimit i gjithë dokumentacioni që do të administrohet pastaj kur themi “dokumentohet” do të jetë pjesë e materialit zgjedhor? Pra, do të jetë pjesë brenda e kutisë së materialeve zgjedhore në fund. Unë mendoj që mbase duhet të jetë një formulim tjetër dhe jo në formatin e dokumentimit me materialin zgjedhor sepse në qoftë se do të jetë dokumentim atëhere ajo do të jetë një provë e plotë, e cila do të përdoret nga administrata zgjedhore ose nesër edhe nga KASI por në qoftë se do të themi do të dokumentohet të paktën në vlerësimin tim sipas këtij kuptimit do të thotë që do të

*Zbardhi materialin e inçizuar
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.28.12.2020*

jetë pjesë e materialit zgjedhor brenda. Kështu që në qoftë se ky process do të jetë nën monitorimin e kamerave që ne kemi miratuar është tjetër proces. Pra është një proces transparent i cili automatikisht do jetë çdo procedurë brenda Qendrës së Votimit. Nëndërkohë të paktën sipas këtij formulimi unë e shoh në qoftë se do dokumentohet ai pastaj do të jetë pjesë e materialit zgjedhor. Edhe këtu unë shoh pak vështirësi. Për më tepër kur ne kemi vendosur edhe disa kritere edhe të paktën në dijenin time domethënë nuk është se është shumë e aksesueshme dhe përdorimi i aparateve telefonikë ose filmik të paktën në dijenin time siç kemi votuar edhe në aktet e mëpërshme aparatit e mban vetëm sekretari për pjesën e komunikimit me KZAZ ose me përfaqësues të tjerë të administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Kështu që e shoh pak të vështirë këtë për tu administruar si dokument ky material filmik.

Z.I.Celibashi: Kjo është e gjitha në të drejtën tuaj për ta vlerësuar! Por ideja këtu është që në kuptim të dokumentacionit zgjedhor është ai dokumentacion i cili do të prodhohet për rastin konkret material filmik ai i cili do të prodhohet nga kamerat të cilat do të vendosen në Qendrën e Votimit. Edhe nga ana tjetër ideja është për të dhënë një lloj konsenti që nëse ekziston mundësia të bëhet edhe evidentimi në një material filmik i këtij momenti.

Znj. H.Vukaj: (Nuk dëgjohet)... Të dimë të kësaj detyre të ngarkuar apo jo?

Z.D.Çaka: A do jetë provë ky document në qoftë se nuk do të administrohet në materialin zgjedhor edhe ky është gjithë procesi im dhe jo kamera që do filmojë kamerat brenda ambjentit që do të bëjë vetëm pjesën e administrimit të gjithë procesit. Po them për këto filmime kur ne e citojmë në një akt se si pastaj palët do

*Zbardhi materialin e inçizuar
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.28.12.2020*

të përdorin ato prova që mund të kenë nëse do të kenë ankesa në KAS. Unë e shoh pastaj në diskrecionin e secilës palë të përdori ato prova të cilat ajo i konsideron të nevojshme për të arsyetuar pretendimin që kanë.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Ardita VRIONI*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.28.12.2020*

Z.M.Çakaj: Më falni, po kush nga këta palë legjitimohet që të shkojë në KAS? Së pari. Së dyti. Po jo unë nuk shikoj personalisht asnjë, së dyti unë bie dakord me deklarin e komisionerit që dokumentimi si material filmik duke qenë se në akte të tjera të mëparshme nuk e lejojnë prezencën fizike të celularit në komisionin e qendrës së votimit, dokumentimi si material filmik fare mirë mund të bëhet nga kamerat të cilat do të vendosen në mënyrë të tillë që nuk lejojnë ose më saktë garantojnë parimin e fshehtësisë së votës, kështu që fare mirë kjo mund të përdoret dhe nuk kemi të bëjmë me një dokumentim në kuadër ose në koncept të administrimit si material filmik së bashku me materialet e tjera pra është dokumentin i veçantë, kështu që nuk e përziejme me materialet e tjera, konkretisht procesverbalin e veçantë apo materialet e tjera zgjedhore. Unë i gjej fare mirë rrijnë bashkë që të gjitha.

Znj.H.Vukaj: Personalisht edhe unë e gjej në rregull propozimin dhe nuk mendoj që është një material i veçuar filmik, ku mund t'i jepet mundësia gjithkujt të përdori një mjet të ndaluar por materiali filmik ashtu sikundër e përmendi Komisioneri, mund të jetë një segment i materializuar edhe veçmas në rast se do të kërkohet nga kamerat e instaluar në këto ambiente dhe përveç kësaj dokumentimi në material filmik, i përfshirë në këtë pikë, do të thosha që rrit përgjegjësitë karshi personit të autorizuar për të administruar dhe dorëzuar vulën rezervë. Faleminderit!

Znj.I.Nano: Zoti Çaka! Komentet tuaja do t'i materializoni me ndonjë propozim konkret?

*Zbardhi materialin e inçizuar
Romina Kokoshi*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.28.12.2020*

Z.D.Çaka: Po meqënëse është ideja dhe nëqoftëse unë e kam kuptuar drejt ky material filmik do të jetë pjesë e kamerave të sigurisë, unë do të sugjeroja ose do të bëja një propozim që të shtohet të dokumentohet me material filmik, mbas termit filmik nga kamerat e sigurisë në të ndodhura në qendrën e votimit dhe për këtë jam plotësisht dakord pra ky monitorim për mua nga pikëpamja ime është tërësisht normal madje dhe shumë i pranueshëm ndërsa ajo çfarë unë kisha parantezën tek pjesa tjetër se çfarë mund të kishte materiale filmike me aparate të tjera, megjithatë unë do të bëja këtë propozim.

Znj.I.Nano: Atëherë ideja juaj është për të saktësuar, pra jeni dakord me dokumentimin e materialit filmik.


Z.D.Çaka: Po, po

Znj.I.Nano: Por për të shtuar pas fjalës filmik, nëpërmjet kamerave të instaluar në çdo qendër votimi. Kolegë nëse nuk ka propozime të tjera le të votojmë, po ju drejtohem edhe njëherë keni propozim tjetër për këtë pikë, për pikën 7? Nëse nuk ka propozime të tjera..

Znj.H.Vukaj: Rregullim gramatikor aty ku thuhet orën e marrjes në dorëzim të vulës rezervë dhe nëpunësin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që kreu dorëzimin.

Znj.I.Nano: Në cilën pikë ju lutem?

*Zbardhi materialin e inçizuar
Romina Kokoshi*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.28.12.2020*

Znj.H.Vukaj: Në gjurmën ç, të pikës 7, nëpunësin e Komisionit.

Znj.I.Nano: Dakord. Administrata gjatë zbardhjes do të reflektojë edhe këto vërejtje dhe do të rishikojë gjerësisht aktin.

Atëherë votojmë propozimin e Zotit Çaka për një shtesë në gjurmën b të pikës 7 të projekvendimit, me këtë përmbajtje pas tog fjalëshit material filmik të shtohet nëpërmjet kamerave të instaluar në qendrën e votimit.

Kush është dakord të nderuar kolegë?

Pro: 5 (Znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, Znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka


Miratohet neni 7 me ndryshimin e propozuar nga zoti Çaka!

Znj.I.Nano: Viojmë me pikën 8. Në rast se njoftimi sipas paragrafit 4 të këtij paragrafi bëhet për vulën e komisionit të qendrës së votimit dhe për vulën e kryetarit të komisionit të qendrës së votimit, të së njëjtës qendër votimi, atëherë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve:

a.Pas administrimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve të njoftimit, kërkesës të sekretarit të komisionit të zonës së administrimit zgjedhor,

Merr vendim për nxjerrjen jashtë përdorimit të vulës së komisionit të qendrës së votimit dhe të vulës së kryetarit të qendrës së votimit përkatëse dhe zëvendësimin e tyre. i.Vula e Komisionit të qendrës së votimit e nxjerrë jashtë përdorimit zëvendësohet me vulën rezervë me tekstin unik të asaj qendre votimi. 2i. Vula e kryetarit të komisionit të qendrës së votimit e nxjerrë jashtë përdorimit zëvendësohet me vulën rezervë me tekstin unik të njëjës nga qendrat e votimit të asaj zone të administrimit zgjedhor.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Romina Kokoshi*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.28.12.2020*

b. Vendimi i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve sipas shkronjë a të këtij paragrafi, përcakton numrin e QV, tekstin e secilës vulë që nxirret nga përdorimi, dhe tekstin e secilës vulë rezervë që zëvendëson vulat e nxjerra nga përdorimi. Çelimi diskutimin për pikën 8 të projekt vendimit. Përfaqësuesit e partive politike ju lutem?

Dakord. (Të gjithë shprehen dakord).

Z.Kaziaj, keni ndonjë koment apo ndonjë propozim?

Dakord. (Të gjithë shprehen dakord).

Të nderuar kolegë për pikën 8?

Dakord. (Të gjithë shprehen dakord).

Nuk kemi propozime për shtesa apo ndryshime. Atëherë më duhet të kaloj në votimin e pikës 8,

Kush është dakord sipas tekstit të ardhur nga Komisioneri?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Miratohet pika 8!

Pika 9 e projektvendimit! Në rastet e nxjerrjes jashtë QV-së të vulës së komisionit të QV-së, apo të vulës së kryetarit të Komisionit të QV-së, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve referon materialin kallëzues pranë organit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor ku komisioneri ka vendbanimin. Keni ndonjë koment lidhur me pikën 9 të projektvendimit? Përfaqësues të partive politike?

Z.D.Çaka: Mund të shtoja diçka, nëse?

Znj.I.Nano: Po!

***Zbardhi materialin e inçizuar
Romina Kokoshi***



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.28.12.2020*

Z.D.Çaka: Eshtë cituar që, kjo është më shumë, ku komisioneri do bëjë pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor ku komisioneri ka vendbanimin, pra një pyetje qëllimi është që atje ku ka komisioneri vendbanimin apo atje detyrimisht ku ndodhet qendra, sepse mund të ndodhi që psh, marrim qarkun e Tiranës që mund të jetë një zonë zgjedhore dhe mund të jetë banor edhe nëpër qytete të tjera, bashki të tjera të cilat kanë prokurori të veçanta, psh në Kavajë, ndërkohë mund të jetë anëtar i QV-së në Bashkinë e Tiranës. Po flasim për zgjedhjet e pushteti qendror gjithmonë, për Kuvendin e Shqipërisë.

Z.M.Çakaj: Nuk lejohet, nuk lejohet, duhet të jetë brenda KZAZ-së.

Z.A.Kazaj, përfaqësues i LSI: Duhet të jetë brenda KZAZ-së, edhe nëqoftëse nuk ishte ky parashikim Prokuroria..

Z.D.Çaka: Po atëhere është shumë e thjeshtë që mund të bëhet se ku ndodhet KZAZ, qendra e votimit më fal.

Znj.I.Nano: Në fakt unë ke kjo pikë kam një koment.

Z.M.Çakaj: Kjo nuk lidhet me personin, lidhet më shumë me Kodin e Procedurës Penale dhe lidhet me personin ku,

Znj.I.Nano: Me vendin është në fakt ku kryhet vepra penale, unë kam një koment dhe një propozim tjetër. referuan nenit 103, nëse KQZ-ja arrin në përfundimin që kemi të bëjmë me një vepër penale dhe referon materialin kallëzues pranë Prokurorisë përkatëse, do të duhet të shtonim edhe dëmtimin e qëllimshëm, pra në

*Zbardhi materialin e inçizuar
Romina Kokoshi*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.28.12.2020*

fjalinë e fundit të pikës 1 të nenit 103 thuhet: Dëmtimi i qëllimshëm ose nxjerrja e vulës jashtë QV-së përbën vepër penale. Pra në pikën 9 është parashikuar që materiali kallëzues referohet vetëm në rastin e nxjerrjes jashtë QV-së, i cil është dhe ndër rastet që zëvendësohet, pra, po më lejoni të lexoj 2 fjalitë e para të nenit 103, fjalinë e dytë, “në rastet se një nga vulat është dëmtuar ose nxjerrë jashtë QV-së, atëhere bëhet zëvendësimi me vulën rezervë” dhe është dëmtimi i qëllimshëm vepër penale, pra që të bëjë, të referojë në Prokurori KQZ-ja, do të duhet që të parashikojë dhe rastin e dëmtimit të qëllimshëm mendoj,

Znj.H.Vukaj: Kam përshtypjen që duhet të jetë, Rastet janë të dyja konkurrese paralelisht.

Znj.I.Nano: Pra propozimi im është ky, në rastet e dëmtimit të qëllimshëm ose nxjerrjes jashtë QV-së të vulës, pra të shtohet edhe dëmtimi i qëllimshëm. Dhe propozimi i Z.Çaka për rrethin gjyqësor ku ndodhet QV-ja.

Z.D.Çaka: Po doja të bëja dhe një sqarim, po meqënëse pati një diskutim. Anëtar i Komisionit të QV-së, mund të jetë banor në zonën zgjedhore dhe jo në KZAZ, se minimalisht Tirana ka më shumë se 1 KZAZ dhe është në zonën zgjedhore, e ka neni 38 dhe zona zgjedhore është ndarja administrative sipas qarkut të përcaktuar tek përkufizimet, pra nëse do të citojmë ku komisioneri ka vendbanimin, duhet të kemi parasysh edhe Prokurori të tjera të cilat mund të jenë të ndryshme nga ato ku është zona zgjedhore, ku është QV-ja. Neni 38 thotë të jetë me vendbanim brenda zonës zgjedhore përkatëse, dhe zona zgjedhore është qarku i Tiranës në rastin konkret ose qarqe të veçanta, kështu që unë propozoj që të jetë ku ndodhet QV-ja, pranë Prokurorisë, për më tepër jo duke elidhur me personin por me ngjarjen dhe

*Zbardhi materialin e inçizuar
Romina Kokoshi*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.28.12.2020*

ky është edhe nocioni i Kodit Penal, që nuk e lidh me venbanimin e personit por me vendin ku ndodh ngjarja.

Z.I.Celibashi: Po nëse më lejoni edhe si propozues, them më mirë ta evitojmë ndoshta kompetencën territoriale, se nuk varet aspak nga ajo sesi urdhërojmë ne në aktin tonë, por thjesht të evidentojmë faktin që referohet në organin e Prokurorisë ky si moment dhe kjo mjafton.

Z.D.Çaka: Unë personalisht jam dakord me këtë propozim.

Znj.I.Nano: Pra kemi 2 propozime për këtë pikë. Një propozim nga ana ime që të shtohet dhe dëmtimi i qëllimshëm dhe propozimi tjetër është që pika dhe fjalia të mbyllet pranë organit të Prokurorisë, ose pranë Prokurorisë përkatëse. Atëhere së pari votojmë për propozimin tim për të shtuar dhe rastet e dëmtimit të qëllimshëm duke e riformuluar. Në rastet e e dëmtimit të qëllimshëm ose nxjerrjes jashtë QV-së të vulës dhe vijon fjalia,

Kush është dakord me këtë propozim ju lutem?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Miratohet!

Dhe propozimi tjetër është që fjalia të përfundojë pranë organit të Prokurorisë përkatëse, kush është dakord me këtë propozim?

Znj.H.Vukaj: Në fakt organet kompetente duhet të jetë, ndoshta është më e saktë, një sugjerim.

*Zbardhi materialin e inçizuar
Romina Kokoshi*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.28.12.2020*

Z.A.Kaziaj, përfaqësues i LSI: Kompetent për territorin duhet shënuar si rregull, se vepron në bazë të territorit.

Z.M.Çakaj: Fjala e duhur në Kodin e Procedurës Penale, është kompetenca tokësore, e parashikon neni 76, rregulla të përgjithshme, kompetencën tokësore dhe në rast se nuk dihet vendbanimi, atëhere, ne se nuk mund të identifikohet kompetenca tokësore, atëhere kalojmë tek pika e 2 neni 76 që është vendbanimi i të pandehurit, gjithsesi unë do isha dakord me propozimin e bërë nga Komisioneri, që pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor kompetente.

Znj.I.Nano: Dhe me kompetent kuptojmë edhe atë lëndore se të mos harrojmë që kemi hera herës ndryshime dhe i ngarkohen edhe SPAKUT, ka patur ndryshime hera herës. Kështu që, Organit të Prokurorisë kompetente, ose Prokurorisë kompetente.

Znj.I.Nano: Kush është dakord? Po z.Nuraj?

Z.L.Nuraj, përfaqësues i PD-së: Do të propozoja pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor përkatës dhe kjo e përmbledh edhe ku është QV-ja në të cilën ka ndodhur vepra penale. Rrethi Gjyqësor përkatës, që mos të ngatërrohem pastaj mes Prokurorive të rrethit apo prokurorive të posaçme.

Znj.H.Vukaj: U sqaruar për ndryshimet që kanë ndodhur deri tani në lëndë apo në kompetencë me ndërhyrjen edhe të organeve të reja, kështu që propozimi i saktësuar nga Komisioneri mendoj dhe me gjithë këto ndërhyrje që bëme ne, për ta

*Zbardhi materialin e inçizuar
Romina Kokoshi*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.28.12.2020*

konsoliduar më mirë, mendoj se dhe sugjeroj që Prokurorisë kompetente do të ishte më mirë.

Znj.I.Nano: Atëhere kemi 2 propozime, ai i Komisionerit i formuluar nga znj.Vukaj, Prokurorisë kompetente dhe kemi dhe një propozim të Z.Nuraj Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor përkatës. Votojmë ju lutem propozimin e znj.Vukaj, sipas propozimit të Komisionerit?

Kush është dakord me këtë propozim?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Miratohet!

Atëherë më 5 vota pro pranë organit të Prokurorisë kompetente. Z.Nuraj meqenëse u votua me 5 vota pro propozimi i znj.Vukaj, nuk po hedhim për votim propozimin tuaj.

Z.L.Nuraj, përfaqësues i PD-së: Dakord!

Znj.I.Nano: Faleminderit! Me shtojca dhe përmirësime nga të gjithë kolegët. Pika 10 ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe pika 11 parashikimi i ankimit kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit, Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

Kush është dakord me pikën 10 së pari?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Miratohet!

Votojmë dhe pikën 11. Kush është dakord ju lutem?

*Zbardhi materialin e inçizuar
Romina Kokoshi*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së KQZ-së
Komisioni Rregullator
Dt.28.12.2020*

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Miratohet!

Eshtë momenti për të votuar në tërësi projektvendimin pasi e kemi votuar atë në parim, e kemi votuar dhe për çdo pikë dhe e kemi votuar ndryshimet sipas propozimeve. Votojmë atëherë në tërësi projektvendimin “për caktimin e rregullave të administrimit dhe të shpërndarjes së vulës rezervë të komisionit të QV-së”.

Kush është dakord të nderuar kolegë?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundër: S'ka

Miratohet!

Sapo miratuam me pesë vota projektaktin “për caktimin e rregullave të administrimit dhe të shpërndarjes së vulës rezervë të komisionit të QV-së”. Meqenëse kjo mbledhje kishte vetëm këtë pikë në rendin e ditës, mbledhjen e deklaroj të mbyllur, natën e mirë!

Vendimi nr.11

*Zbardhi materialin e inçizuar
Romina Kokoshi*

